

VENDIM
Nr.77, datë 4.2.2005

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.766, DATË 8.12.1998 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE
TEKNOLOGJIKE USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e dytë të pikës 1, afati “...deri në 31.12.2003” zëvendësohet me “...deri në 31.12.2005”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pagesën e gatishmërisë e përfitojnë 200 punonjës të kombinatit mekanik, në Poliçan, 11 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse, në Elbasan dhe 9 punonjës të uzinës mekanike, në Gramsh.”.

c) Në fund të pikës 4 viti “...2003...” zëvendësohet me “...2005...”.

2. Fondi prej 37 000 000 (tridhjetë e shtatë milionë) lekësh, i nevojshëm për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Pagesë papunësie” miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI